

Broshurë,  
3-mujori i tretë,  
2023



ALBANIAN ASSOCIATION OF BANKS  
SHOQATA SHQIPTARE E BANKAVE



# PËRGJEGJËSIA SOCIALE E KORPORATAVE

Korrik - Shtator 2023



Zhvillimi i qëndrueshëm është harmonizimi i zhvillimit ekonomik, dhe mbrojtja e mjedisit për të plotësuar nevojat e të sotmes, pa rrezikuar mundësitë që edhe brezat e ardhshëm t'i shfrytëzojnë këto kapacitete dhe t'i përmbushin nevojat e veta.






**Intesa Sanpaolo Bank Albania:**

- ▶ U bë pjesë e aktivitetit “Pedalim me B biçikletë” organizuar nga Bashkia Tiranë, në kuadër të “Javës Evropiane të Lëvizshmërisë”. 16 punonjës të bankës morën pjesë.
- ▶ Në datën 13 shtator, Grupit Intesa Sanpaolo organizoi një webinar mbi mënyrat e të ushqyerit shëndetshëm, si dhe në përmirësimin e rutinës tonë dietike pa shkaktuar humbje ushqimore. Aktiviteti u ndoq nga punonjësit e Divizionit Ndërkombëtar të Bankave Filiale.
- ▶ Prezantoi një ofertë të re me zero komision administrimi dhe me norma më të ulëta interesi për të mbështetur sektorin e agrobiznesit. Agrobizneset patën mundësinë të përfitonin nga oferta e dedikuar për Paradhënien bankare (overdraft) dhe/ose Agro Kapital Qarkullues.



**Procredit Bank:**

- ▶ Në Ditën Ndërkombëtare pa Qese Plastike, banka risolli në vëmendje ndikimin ekologjik të qeseve plastike në planetin tonë. Brenda ambienteve të bankës bëhet organizimi i duhur i mbetjeve duke ndarë në kosha të veçantë mbetjet në bazë të materialeve.
- ▶ Është certifikuar sipas standardit ISO 14001:2015. Sipas këtij standardi ndërkombëtar, TÜV AUSTRIA Albania ka audituar sistemin e menaxhimit mjedisor të ProCredit Bank dhe konfirmon që banka zbaton suksesshëm në strukturën dhe veprimtarinë e saj një sistem menaxhimi mjedisor efektiv.
- ▶ Në bashkëpunim me Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim banka ofron mundësi për të realizuar investime në banesat e individëve nëpërmjet kredisë GEFF. Pasi investimi ka përfunduar, huamarrësit do të kenë mundësi të aplikojnë për të përfituar grant deri në 20% të shumës së kredisë, financuar nga Bashkimi Evropian.



**Raiffeisen Bank:**

- ▶ Në vijim të mbështetjes së projekteve në ndihmë të komunitetit, iu bashkua edhe këtë vit nismës së Forumit të Mendimit të Lirë dhe Korpusit të Vullnetarëve, për pastrimin e disa zonave bregdetare. Banka mbështet këtë projekt prej 15 vitesh, duke treguar përkushtim në mbështetjen e Zhvillimit të Qëndrueshëm, për një kauzë kaq të rëndësishme siç është ruajtja dhe mbrojtja e mjedisit. Iniciativa e pastrimit të plazheve u shpërnda në 4 aksione të ndryshme në plazhet e Zvërnecit, Velipojës, Spillesë dhe Tales.





**Intesa Sanpaolo Bank Albania** dhe Eurizon Capital S.A janë shoqëritë e para që licencohen nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare për t'u ofruar qytetarëve shqiptarë qasje të drejtpërdrejtë në investimet kolektive në Bashkimin Evropian dhe t'u ofrojë klientëve vendas mundësi investimi për të zgjeruar gamën e produkteve në portofolin e tyre. Më datë 20 shtator 2023, u zhvillua aktiviteti i prezantimit në Rezidencën e Ambasadorit Italian në Tiranë.


**Banka OTP Albania** në përkrahje të traditës dhe promovimit të produktit dhe kulinarisë vendase, ka mbështetur "Festën e Birrës", një aktivitet traditë i qytetit të Korçës.





### Procredit Bank:

- ▶ Onboarding Programme është një praktike disa vjeçare e ProCredit Bank me qëllim trajnimin, zhvillimin personal dhe profesional si dhe punësimin e të rinjve të sapo diplomuar. Gjatë kësaj periudhe nëpërmjet këtij programi stafit i janë bashkuar rreth 10 të rinj. Banka u bë pjesë e mirëseardhjes së studentëve të Universitetit Epoka për vitin e ri akademik. Të pranishëm në këtë aktivitet ishin edhe përfaqësues të Burimeve Njerëzore të bankës, të cilët informuan dhe diskutuan me studentët e pranishëm mundësitë që ofron Onboarding Programme.
- ▶ Për herë të parë në Shqipëri u ofrua shërbimi i pagesave nga portofoli digjital me Google Pay. Promovimi i këtij shërbimi nëpërmjet spoteve publicitare, postimeve dhe artikujve ka qenë një prej fokuseve të bankës gjatë këtyre muajve.
- ▶ Banka u bë pjesë e Panairit FUTURE2TECH 2023, ku pjesëmarrësit morën informacione rreth risive financiare në epokën digjitale. Përfaqësuesja e bankës ishte pjesë e panelit Fintech për të biseduar rreth inovacioneve në fushën e teknologjisë.







### Banka Amerikane e Investimeve (ABI):

- ▶ Klubi "GO-3G", projekt i cili konsiston në ndihmë të komunitetit shkollor të mësuesve dhe drejtuesve brenda shkollës 9-vjeçare "Naim Frashëri" (një shkollë Qendër Komunitare në qytetin e Korçës) duke ofruar një mjedis të qëndrueshëm krijues dhe zhvillimor për më tepër se 106 fëmijë dhe duke lehtësuar veprimtaritë ekstra-kurrikulare sociale/komunitare të shkollës, ndërmjet tre brezave: fëmijët e shkollës /vëllezërit e motrat e tyre, prindërit, gjyshërit dhe kujdestarët e tjerë të fëmijëve në nevojë. Projekti u realizua në bashkëpunim me Dorcas Aid International Albania.
- ▶ Mbështeti Shoqatën e Basketbollit Dinamo për realizimin e "Summer League". Ky aktivitet u realizua me fëmijët e grupit U – 14 përgjatë muajve qershor –korrik, me qëllim nxitjen e të rinjve për t'u angazhuar sa më shumë në veprimtari sportive.
- ▶ Mbështeti Arkivin Shtetëror Qendror të Filmit dhe Qendrën për Kulturë dhe Art bashkëkohor "Harabel" në realizimin e digjitalizimit dhe restaurimit të filmit "Mësonjëtorja".

### Banka Kombëtare Tregtare (BKT):

- ▶ Mbështeti aktivitetin 4 ditor "Gusht e n'fest" organizuar nga Bashkia Gramsh. Aktiviteti kishte për qëllim promovimin e Gramshit për rritjen e turizmit dhe mbështetjen e traditave të kuzhinës dhe kulturore.
- ▶ Në kuadër të bashkëpunimit të vazhdueshëm të BKT-së me universitete të ndryshme në Shqipëri, 24 studentë nga Fakulteti i Ekonomisë në Tiranë vizituan ambientet e Zyrës Qendrore të BKT-së të shoqëruar nga Zëvendës Dekani i Fakultetit. Studentët u njohë me historinë e bankës, vlerat që kanë qeverisur institucionin që nga themelimi i tij, mundësitë e karrierës dhe përfitimet e punonjësve, dhe u takuan me drejtues të lartë të bankës.





- ▶ Njëpërmjet Fondit Shqiptar të Zhvillimit dhe në bashkëpunim me Shkollën e Financës dhe Menaxhimit të Frankfurtit (FS) dhe Bankën Gjermane për Zhvillim (KfW) organizoi një seminar për bizneset fillestare. Tema e trajnimit ishte “Rritja e qëndrueshmërisë së bizneseve fillestare”. Ky trajnim interaktiv shërbeu për njohjen e startup-eve mbi marketingut, sistemin fiskal, rezultatin financiar dhe financimin e planit të investimit dhe promovimin e produktit të kredisë BKT Start-Up BKT për mikro dhe SME-të dhe produkteve të tjera që ofron BKT.



- ▶ Z. Seyhan Pencablıgil, Drejtor Ekzekutiv dhe Anëtar Bordi i BKT-së dhe z. Alastair King-Smith, Ambasador i Mbretërisë së Bashkuar në Shqipëri nënshkruan një marrëveshje bashkëpunimi për bashkë sponsorizimin e programit të bursave “Chevening”. Njëpërmjet këtij partneriteti, BKT synon të inkurajojë të rinjtë shqiptarë nga e gjithë bota, të cilët demonstronë potencialin më të madh për t’u bërë liderë, vendimmarrës, krijues të opinionit, të ndjekin programe prestigjioze akademike në MB, të fitojnë njohuri dhe përvojë ndërkombëtare dhe më pas të kthehen dhe të kontribuojnë në progresin e Shqipërisë.



- ▶ Shkolla “Naim Frashëri” në Korçë u mbështet me dhurimin e 5 kompjuterëve për laboratorin e IT të shkollës.

### Credins Bank:

- ▶ Sponsorizoi zyrtarisht koncertin e Ricky Martin.
- ▶ Vjosa River Volley - Një tjetër aktivitet sportiv i zhvilluar në qytetin e Përmetit, nën moton “Argëtohem me Vjosën, Mbrojmë Vjosën”, u mbështet nga banka. Aktiviteti erdhi jo vetëm në formën e argëtimit, por edhe si një mesazh sensibilizues mbi mbrojtjen e trashëgimisë dhe vlerave kulturore, si dhe mbrojtjes së mjedisit.







- ▶ “Ndricho edukimin e tyre” – Ekspozita artistike që solli një bashkëpunim të veçantë mes bankës dhe SOS Fshatrat e Fëmijëve. Një ekspozitë me 20 piktura mjaft frymëzuese e realizuar plotësisht nga vetë fëmijët e fshatit SOS. Mbledhja e të ardhurave nga shitja e pikturave erdhi si mundësi për blerjen e mjeteve shkollore për procesin mësimor 2023-2024.
- ▶ Sven Vath - Aktiviteti kulturor që bëri bashkë dashamirësit e muzikës dance-techno, ishte sukcesi i radhës që u zhvillua në Tiranë, mbështetur nga Credins Bank & Mastercard.



### Intesa Sanpaolo Bank Albania:

- ▶ Gjatë muajit qershor 2023, në bashkëpunim me Kryqin e Kuq Tiranë, organizuan fushatën “Le të ndihmojmë një fëmijë në nevojë!”. Fushata filloi më datë 1 Qershor me rastin e Festës së Fëmijëve dhe vazhdoi përgjatë gjithë muajit, në mënyrë që të mblidheshin sa më shumë ndihma për fëmijët. Kolegët patën mundësinë për t’u ardhur në ndihmë fëmijëve në nevojë duke përgatitur pako me veshje për grupmosha të ndryshme, ose duke kontribuar cash në llogarinë bankare të Kryqit të Kuq. Të gjitha ndihmat dhe fondet e grumbulluara iu dorëzuan ekipit të Kryqit të Kuq, të cilët organizuan një aktivitet në ambientet e Kryqit të Kuq Tiranë më datë 6 Shtator, me rastin e Ditës së Shenjtërimin të Nënë Terezës, e cila korrespondon me Ditën Ndërkombëtare të Bamirësisë. Gjatë aktivitetit, 50 fëmijë u pajisën me çanta dhe të gjitha mjetet e nevojshme shkollore, fletore & veshje.
- ▶ Më datë 16 Shtator 2023, organizoi një aktivitet me temë “Njerëzit krijojnë një skuadër fituese”, i cili u zhvillua në sallën e koncerteve të Qendrës Kulturore të Kishës Ortodokse, ku ishin të ftuar të gjithë punonjësit e Bankës. Në fillim të aktivitetit u nënshkrua “Pakti i Mirëkuptimit dhe Angazhimit”, i përgatitur nga z. Alberto Peretti dhe Genius Faber me kontributin





e 70 kolegëve. Gjatë aktivitetit, Z. Alessandro D’Oria, Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv i Intesa Sanpaolo Bank Albania, ndau me stafin arritjet dhe objektivat për të ardhmen dhe Znj. Suela Totokoçi, Drejtore e Departamentit të Burimeve Njerëzore dhe Organizimit, prezantoi iniciativat e ndërmarra për zhvillimin e njerëzve. Një ndër këto iniciativa ishte “Paneli i të Rinjve”, i cili u prezantua nga pjesëmarrësit e kësaj nisme – stafi i ri nën moshën 30 vjeç. I ftuar special në aktivitet ishte ish-kapiteni i skuadrës kombëtare të futbollit, z. Lorik Cana, i cili ndau eksperiencën e tij personale mbi punën në skuadër dhe si individët krijojnë skuadra fituese. Në mbyllje të aktivitetit, u shpallën tre fitueset e konkursit të kartave të kreditit dhe dy degët fituese.



### Fibank Albania:

- ▶ Mbas tri javësh trajnim në Bullgari, Shkolla Verore e Bullgarishtes në bashkëpunim me Fakultetin e Gjuhëve të Huaja në Tiranë, organizoi më datën 25 korrik ceremoninë e mbylljes së kursit veror gjatë së cilës u shpërndanë certifikatat për studentët pjesëmarrës. të lëshuara nga Universiteti i Veliko Tërnovës dhe të shpërndara nga rektori tij, profesori Dimitar Dimitrov. Banka ishte sponsor i kësaj ceremonie duke shprehur gatishmërinë në mbështetjen e vazhdueshme të projekteve që zhvillojnë dhe forcojnë marrëdhënien kulturore mes Shqipërisë dhe Bullgarisë.
- ▶ #TjetërHerëMeVajzë! Kur pyesim njerëzit përse preferojnë të shtohen më djem më shumë se me vajza, vazhdojnë përmenden idetë e vjetra që prona dhe pasuria u trashëgohet vetëm djemve. Së bashku me partnerët e saj në këtë projekt, UNFPA Albania dhe Fondacioni Spitalor i Nënës dhe Fëmijës, banka është e vendosur të ndalojë praktikën e dëmshme të abortit selektiv me bazë gjinore dhe të fuqizojmë vajzat e kombit.




**Banka OTP Albania:**

- ▶ Në 7 korrik punonjës nga departamente të ndryshme të bankës kontribuan në aktivitetin “Dhuro Gjak”, në mbështetje të fëmijëve me talasemi.
- ▶ Ka ofruar mbështetjen e saj për pajisjen me një kënd studimi dhe kompjuter për një ndër familjet në nevojë duke mundësuar kushtet e përshtatshme për fëmijët.
- ▶ Një nismë interesante dhe sfiduese është dakordësuar mes bankës dhe organizatës SOS /Fshatrat e Fëmijëve në Shqipëri. Banka është bërë partner me SOS në projektin “MoveIT4SOS” – bleu të drejtën e përdorimit të këtij aplikacioni dhe fondet e dhëna do të shërbejnë për vijimësinë e kujdesit që SOS ofron për fëmijët pa kujdes prindëror, të cilët kanë gjetur një shtëpi të ngrohtë pranë SOS.
- ▶ Në të gjithë botën është fakt se 80% e të verbërve lexojnë shumë libra. Edhe në vendin tonë të verbrit janë të pasionuar pas tyre dhe lexojnë shumë. Arsyeja për këtë është mungesa ose vështirësia për qasje në informacion si dhe mungesa e autonomisë në lëvizje, pra të verbrit kanë më shumë kohë të shpenzojnë në shtëpi dhe libri është miku më i mirë për të mbushur hapësirat ditore. Për të mbështetur sa më shumë këtë segment dhe për të përqafuar edhe njëherë mbështetjen për arsimim, banka ka vendosur të sponsorizojë Shoqatën e të Verbërve në Shqipëri për blerjen e audio books dhe pasurimin e Bibliotekës Kombëtare të të verbërve.

**ProCredit Bank:**


- ▶ I bashkohet fushatës ndërgjegjësuese MoveIT4SOS, që mundëson mbledhjen e fondeve për SOS Fshatrat e Fëmijëve Shqipëri. Stafi i ProCredit Bank është sensibilizuar me këtë kauzë dhe është angazhuar të mbledhë sa më shumë kilometra.





### Raiffeisen Bank:

- ▶ “Thyeni barrierat, përmirësoni punën” - në datat 27-28 shtator u zhvillua AI Hackathon. Mbi 50 ekspertë të bankave të rrjetit Raiffeisen u mblodhën në një veprimtari 2 ditore për të ndarë përvojat dhe informacionet e tyre mbi Inteligjencën Artificiale (AI) dhe mënyrën se si AI mund të rrisë produktivitetin e stafit, inovacionin në sistemin bankar dhe përvojën e klientit. Një hackathon dinamike me mbi 100 pjesëmarrës dhe shumë ide frytdhënëse u finalizua me 3 çmime.
- ▶ Mbështeti edicionin e dytë të festivalit Ndërkombëtar të Kërcimit Bashkëkohor në Tiranë, organizuar në 23 shtator deri më 22 tetor.
- ▶ Mbështeti për të dytin vit radhazi, nga data 17-28 korrik, akademinë e Inovacionit “Korça ICT Academy & Code” organizuar nga Bashkia Korçë. Falë këtij projekti, rreth 100 të rinj nga e gjithë Shqipëria morën pjesë në një përvojë të jashtëzakonshme trajnimi.



### Tirana Bank:

- ▶ Nisur nga evidentimi në emisionet investigative “Fiks” dhe “Stop” për dy familje në nevojë dhe kërkesës publike për përmirësimin e kushteve të jetesës, banka u angazhua dhe ofroi mbështetje për secilën prej tyre. Konkretisht, familjes në Krrabë i mundësoi mobilimin e banesës dhe rregullimet më të nevojshme. Kurse familjes në Koplík, veç asistencës financiare, iu siguroi një banesë me qira dhe mobilimi i plotë i saj.
- ▶ Iniciativës së bankës për të mbështetur përmirësimin e kushteve hidrosanitare të shtëpisë së Foshnjës Vlorë, iu bashkua në mënyrë vullnetare edhe stafi i saj. Nën mesazhin “Fëmijët për fëmijët” u mirëprit iniciativa që fëmijët e stafit në mënyrë individuale krijuan punime “crafts” të cilat u shitën në një “ankand” mes punonjësve të bankës. Të ardhurat e mbledhura nga shitja e punimeve iu shtuan fondit





të financimit që banka vendosi për këtë projekt.

- ▶ Ka mbështetur aktivitetin “Nona”, si partner zyrtar i festivalit të gjysheve, që u mbajt në Përmet në datat 11-13 gusht.
- ▶ Mbështeti iniciativën e Bashkisë Pogradec për të rritur kujdesin për pushuesit vendas dhe të huaj që kanë zgjedhur këtë qytet për të pushuar, duke vendosur kulla vrojtimi në vijën bregdetare të liqenit.
- ▶ U realizua kompletimi i laboratorit të fizikës në shkollën “Koli Gusho” dhe laboratorit të Informatikës në shkollën “Muharrem Collaku” në qarkun e Korçës.
- ▶ U kujdes në përmirësimin e cilësisë së shërbimit që i ofrohet komunitetit lokal nga Operatori i Kujdesit Shëndetësor Elbasan, duke vlerësuar rëndësinë e tipologjisë së shërbimeve që banorët përfitojnë nga:
  - Laboratori Bakterologjik që ofron një shërbim jetik jo vetëm për të mirëpritur pacientin por, edhe për të ruajtur një temperaturë konstante për të gjithë bazën materiale që ndodhet aty.
  - Zyra e vaksinave që ofron një shërbim për të gjithë popullatën.
  - Zyra e drejtorisë, ku çdo ditë mirëpreten qytetarë për t’u zgjidhur problemet që hasin, por edhe takimet e rëndësishme institucionale.

#### Union Bank:

- ▶ Union Bank është sponsori gjeneral i Klubit Sportiv Studenti në sezonin sportiv 2023-2024. Klubi organizon veprimtari sportive në disiplina të ndryshme të lojërave me dorë, si: volejball, qitje, mundje, etj., duke përfaqësuar vendin në konkurrimin të ndryshme brenda dhe jashtë tij.
- ▶ Banka ka mbështetur Institutin Harry Fultz në blerjen e disa pajisjeve force për palestrën e shkollës, me qëllim rritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe zhvillimit të aktiviteteve sportive për nxënësit.

